VENDIM
Nr.61, datë 29. 08.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", të nenit 12 shkronja "a", të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 57 pika 2, nenit 58, nenit 59 pikat 2 dhe 3, nenit 60 dhe nenit 61, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin nr.52, datë 14.7.2004 dhe ndryshuar me vendimin nr.101, datë 27.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nenit 3, shtohet neni 4 me titullin "Përkufizime" dhe me përmbajtje si vijon:

1. Termat e përdorur në këtë rregullore, kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

"Kredimarrës i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" është kredimarrësi që përfiton kredi në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj) nga banka, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ardhurat e tij në origjinë gjenerohen në monedhë vendase ose në një monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë;

b) të ardhurat e tij në valutë (monedhë të huaj) mbulojnë më pak se 80% (tetëdhjetë për qind) të këstit të kredisë ose të kredisë në total (kryegjë dhe interes, në varësi të periudhës së llogaritjes) dhe detyrimeve të tjera në monedhë të huaj ose të indeksuara në valutë.

b) Në nenin 7, paragrafi 7.1 në shkronjën a, pas presjes shtohet fraza e mëposhtme:

".. si dhe struktura (funksione) të veçanta për administrimin e rrezikut dhe analizën ekonomike të tij".

c) Në nenin 7, paragrafi 7.4 shtohen shkronjat "c" dhe "d" me përmbajtje si vijon:

c) Banka, në varësi të llojit të kredisë dhe rrezikut të saj, miraton dhe zbaton politika dhe akte të tjera të brendshme, lidhur me kërkesat e kolateralit dhe/ose garancive, në të cilat përcaktohet minimalisht lloji i garancisë dhe raporti i kolateralit me vlerën e kredisë (përfshirë kryegjëja dhe interesi). Aktet e brendshme do të përshkruajnë edhe rastet kur nuk do të kërkohet kolateral/garanci.

d) Banka, për të siguruar kredinë, duhet të kërkojë dhe të sigurohet për vendosjen e një kolateraili dhe/ose garancie, siç është përcaktuar në aktet e brendshme të saj. Rastet e përjashtimeve nga ky rregull duhet të përshkruhen në aktet e saj të brendshme. Në rastet kur kërkohet dhe vendoset kolaterali dhe/ose garancia, banka merr të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen të mjaftueshme të vlerës së tij, gjatë gjithë jetës së kredisë.

c) Në nenin 7, shtohet paragrafi 7.5 me përmbajtjen si vijon:

7.5 Këshilli drejtues, në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në vit:

a) rishikon strategjitë, politikat dhe aktet e brendshme të bankës për aktivitetin kredidhënës dhe administrimin e rrezikut të kredisë, në përputhje me ndryshimet e kushteve të tregut dhe me rregullat e mbikëqyrjes;

b) analizon dhe vlerëson veçanërisht zbatimin e strategjive, politikave dhe akteve të brendshme të bankës për aktivitetin kredidhënës dhe administrimin e rrezikut të tij, duke përfshirë këtu dhe rreziqet nga dhënia e kredive në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë

(monedhë të huaj).

d) Në nenin 17, pas togfjalëshit "Këshilli drejtues i bankës" shtohet fraza si vijon:

"…dhe/ose kur, mbështetur në analizat e tyre, gjykojnë se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja."

e) Në nenin 22/2, shtohen paragrafët 2/1, 2/2 dhe 2/3, me përmbajtjen si vijon:

2/1. Banka ponderon me koeficientin e rrezikut 100% (një qind për qind), për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin, që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, të kësaj rregulloreje dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.3, shkronja "a", të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

2/2. Banka ponderon me koefiçientin e rrezikut 150% (një qind e pesëdhjetë për qind) për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4 pika 2 të kësaj rregulloreje dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.4 shkronja "f" të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

2/3. Totali i kredive në valutë dhe/ose të indeksuara në valutë të bankës për kredimarrësit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, nuk duhet të kalojë 400 për qind të kapitalit rregullator të saj në baza individuale dhe të konsoliduara. Çdo shumë që tejkalon këtë kufi do të zbritet nga kapitali rregullator i bankës për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

f) Në nenin 22/3, shtohet paragrafi 7 me përmbajtjen si vijon:

7. Kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas nenit 22/2, paragrafët 2/1, 2/2 dhe 2/3, do të zbatohen nga subjektet për:

a) kreditë që do të jepen për "Kredimarrësit e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" nga fillimi i muajit shtator i vitit 2008 dhe në vazhdim;

b) kreditë ekzistuese per "Kredimarrësit e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" që do të ristrukturohen nga muaji shtator i vitit 2008 dhe në vazhdim.

g) Nenet 4, 5, 6, 7 dhe në vijim rinumërtohen përkatësisht si neni 5, 6, 7, 8 etj.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU), që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani